

VENDIM
Nr. 11 , datë 20.1.2021

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “GERTI”
SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “e”, të nenit 5, pika 1, germa “e”, të nenit 10, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 9/5 prot., datë 15.1.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi aplikimin e shoqërisë “Gerti” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Gerti” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 5 prot., datë 6.1.2021, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria “Gerti” sh.p.k., është regjistruar pranë QKB-së në datën 17.3.2000, konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” (QKB) me statusin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.).

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Nga analiza e dokumentacionit, në fazën e fillimit të procedurave të licencimit në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “Gerti” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson kryesisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formatit dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, gjerat: “a”, “b” dhe “c”, plotësuar;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, gjerat: “c”, “e”, plotësuar;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, gjerat: “b”, “d”, plotësuar.
- Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

Nenin 9, pika 2, dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor:

- germa “a”/“b” (akti i themelimit/statuti), pa plotësuar. Shoqëria “Gerti” sh.p.k. në vijim do të depozitojë aktin e themelimit dhe statutin e saj në ERE;

- germa “d” (vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë). Plotësuar pjesërisht. Sa konstatuar në ekstraktin e QKB-së, shoqëria veprimtarinë e saj e ushtron edhe në zonën e Librazhdit (zona ku do të zhvillohet projekti i HEC Vardari). Si e tillë, kjo shoqëri, përveç vërtetimeve të gjendjes gjyqësore të lëshuara nga qarku i Dibrës (ku ndodhet selia kryesore e saj), duhet të përcjellë në ERE edhe ato të qarkut të Elbasanit.

Në vijim shoqëria do të depozitojë në ERE vërtetimet e gjykatës dhe prokurorisë së qarkut Dibrë për administratorin e saj dhe vërtetimet e gjykatës dhe prokurorisë së qarkut Elbasan, për vetë shoqërinë dhe administratorin e saj.

Neni 9, pika 3, dokumentacioni financiar dhe fiskal:

- germa “a” (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj institucionit të Sigurimeve Shoqërore). Plotësuar pjesërisht. Shoqëria në vijim do të përcjellë në ERE vërtetimin në lidhje me sigurimet shëndetësore dhe shoqërore;

- germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.). Plotësuar pjesërisht. Duke qenë se kjo shoqëri është aplikante edhe për prodhimin e energjisë elektrike, do t’i kërkohet të specifikojë kapitalin financiar që dedikon për tregtimin e energjisë elektrike.

Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimin të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8:

- germat: “a”/“d” (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar në gwh/sipas viteve);

- germa “b” (kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti);

- germa “c” (lista e kontratave të mëparshme, nëse ka pasur);

do të njoftohet subjekti, që në bazë të neneve 10, pika 10 dhe 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Gerti” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimin të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti